



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

Draft

Plani i aktiviteteve për përmirësimin e cilësisë së ajrit vjeshtë-dimër
2017-2018

Prishtinë, Nëntor 2017

*Grupi Punues për përgatitjen e Planit të aktiviteteve për përmirësimin e cilësisë së ajrit sipas
Vendimit të Ministres znj. Dr. Albena Reshitaj nr. 54, datë: 17.10.2017*

- 1. Ilir Morina*
- 2. Leutrim Sahiti*
- 3. Muhamet Malsiu*
- 4. Letafete Latifi*
- 5. Bedri Halimi*

Përmbajtja:

- I Gjendja aktuale
- II Korniza Ligjore
- II Objektivat
- III Veprimet (Masat dhe Implementimi)
- IV Rezultatet e pritshme
- V Shtojca

I. Gjendja aktuale

Gjendja e ajrit në Kosovë me theks të veçantë në pjesën qendrore gjatë viteve të fundit ka qenë e rënduar, ku janë regjistruar tejkalime mbi normat e lejuara me ndotësit PM10, PM2.5, NO₂, SO₂ etj. Tejkalime të theksuara fillojnë gjate muajit nëntor duke u intensifikuar në dhjetore, janar, shkurt dhe duke rënë gradualisht në mars, prill. Kjo dukuri është prezentë edhe në regjion dhe me gjere.

Kjo gjendje vije kryesisht si pasojë e shkarkimeve të ndotësve në ajër nga industria, transporti, ekonomive familjare dhe bizneseve të vogla gjatë këtij sezoni, duke i shtuar edhe kushtet meteorologjike të pafavorshme për shpërndarjen e ndotjes.

Kjo situatë ka sjelle nevojën për trajtimin e veçantë të këtij problemi dhe vendosjen e kësaj çështje në prioritet të MMPH dhe Qeverisë së Kosovës.

Problemi i ndotjes së ajrit nuk mundë të trajtohet si i veçuar nga gjendja e përgjithshme socio-ekonomike, prandaj plani i aktiviteteve përfshinë edhe sektorë tjerë zhvillimore dhe institucione tjera relevante që kanë përgjegjësi të caktuara në zbatimin e legjislacionit dhe akteve tjera nënligjore. Ky plan obligon të gjithë akteret përfshirë edhe pushtetin lokal, universitetet, shoqërinë civile dhe çdo person i cili në një apo formë tjetër përdorë lëndë djegëse të çfarëdo lloji dhe shkarkon ndotje në atmosferë.

II. Korniza ligjore

Për menaxhimin e cilësisë së ajrit përfshihen Ligje, UA dhe dokumente të bazuar në legjislacionin e BE dhe të përshtatura sipas gjendjes socio-ekonomike të vendit, si:

- Ligji Ligji Nr. 03/L-025, për mbrojtjen e mjedisit,
- Ligji Nr. 03/L-160, Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja,
- Udhëzimi Administrativ Nr. /2007, për Normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme,
- Udhëzimi Administrativ Nr.04/2009, për kontrollin e emisioneve të bashkë dyzimeve organike të avullueshme gjatë deponimit zbrazjes, mbushjes dhe transportimit të karburanteve,
- Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr. 21/2013, për arsenin, kadmiumin, merkurin, nikelin, dhe hidrokarburet aromatike policiklike në ajër,
- Udhëzimi Administrativ(16.08.2010), për kriteret për përcaktimin e pikave monitoruese, numrin dhe shpeshtësinë e matjeve, klasifikimin e ndotësve të cilët monitorohen, metodologjinë e punës, formën dhe kohën e raportimit të dhënave,
- Udhëzimi Administrativ, Nr.02/2011, për normat e cilësisë së ajrit,
- Udhëzimi Administrativ, Nr. 08 /2016, për normat e lejuara të shkarkimeve në ajër nga burimet e lëvizshme të ndotjes,
- Udhëzimi Administrativ(MTI) Nr. 01 /2017, për cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës.

Si pjesë e programit të përgjithshëm për mbrojtjen e mjedisit, është edhe Strategjia për Cilësinë e Ajrit për vitin 2013-2022, e aprovuar në Kuvend me datën 19.12. 2013, Nr. 04/V-741.

Poashtu MMPH ka përfunduar draft Planin e Veprimit për Cilësinë e Ajrit 2018- 2020, për të cilin gjithashtu janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme për tu dërguar në Qeveri për miratim.

Për të bërë përafrimin e legjislacionit për fushën e ajrit dhe implementimin e tij sa më të mirë MMPH ka ndryshuar dhe plotësuar Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja LIGJI Nr. 03/L-160, për të cilin janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme dhe pritet të dërgohet në Qeveri për miratim.

III. Objektivat

Me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe përgjegjësisë në nivelin qendror dhe lokal të implementimit ligjor dhe të ndërmarrjes së masave për ndotësit, dhe me qëllim të kontrollit dhe vetëdijesimit të operatorëve ekonomik, ekonomive familjare dhe të secilit individ të shoqërisë, ky plan parasheh këto objektiva:

- Përmirësimi i cilësisë së ajrit;
- Rritja e nivelit të zbatimit të legjislacionit dhe përgjegjësiwe institucionale;
- Ngritja e nivelit të edukimit dhe ndërgjegjësimit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja.

IV. Veprimet (Masat dhe Implementimi)

1. Veprimet e ndërmarra deri me tani për përmirësimin e gjendjes aktuale

Me qëllim të përmirësimit të gjendjes aktuale MMPH deri me tani ka ndërmarr këto veprime:

- Është formuar grupi punues për hartimin e “Planit të aktiviteteve për përmirësimin e cilësisë së ajrit”;
- Është formuar grupi punues për “Ngritjen e gatishmërisë për monitorimin dhe raportimin e cilësisë së ajrit”;
- Është themeluar grupi punues për “Identifikimin e ndotësve dhe shkarkimeve në ajër”;
- Është rritur informimi i publikut për cilësinë e ajrit në baza ditore dhe informimit përmes mediave;
- Janë shtuar aktivitetet për vetëdijësimin e publikut për mbrojtje nga ndotja e ajrit, përmes përgatitjes së udhëzuesve përkatës;

- Është rritur niveli i koordinimit me institucionet tjera përgjegjëse për sektorin e ajrit me që rast janë mbajtur takime dhe janë dërguar kërkesa MZHE, MAPL, MTI, MPB dhe MI, për ti zbatuar obligimet që dalin nga legjislacioni për ajrin;
- Është rritur niveli i bashkëpunimit dhe komunikimit me komunat e Kosovës dhe me organizatat e shoqërisë civile;
- MMPH përmes Inspektoratit ka kërkuar nga KEK-u dhe operatorët e tjerë ekonomik që të ndërmarrin të gjitha masat teknike, profesionale dhe ligjore në zvogëlimin e emisioneve ndotëse në ajër.

Përkundër aktiviteteve të ndërmarra deri tani, me qëllim të përmirësimit të gjendjes nevojiten edhe masa tjera shtesë të cilat do të rrisnin efikasitetin e zbatimit të legjislacionit dhe akteve ligjore, zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për cilësinë e ajrit, rritjes së nivelit të bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve dhe ngritjen e kapaciteteve teknike dhe humane.

2. Veprimet që duhet të ndërmerren

- Te monitorohet nga institucionet përgjegjëse qendrore dhe lokale në implementimin e legjislacionit në sektorët që ndërliken me ndikimet në ajër;
- Të fillohet me zbatimin e Udhëzimit Administrativ, Nr. 08 /2016, për normat e lejuara të shkarkimeve në ajër nga burimet e lëvizshme të ndotjes;
- Të rritet kontrolli i cilësisë së derivate që importohen dhe shiten në Kosovë sipas Ligjit Nr. 2004 /5 për Tregtinë me Naftë dhe Derivate të Naftës në Kosovë, Ligjit Nr. 03/L-138 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2004/5 për Tregtinë me Naftë dhe Derivate të Naftës në Kosovë dhe U.A. Nr. 07/2012 për Cilësinë e Karburanteve të Lëngëta të Naftës;
- Vlerësimi i ndikimit në shëndetin publik në bazë të krahasimit të normave të sëmundjeve dhe vdekshmërisë që i atribuohet ndotjes së ajrit;
- Të promovohet dhe subvencionohet transporti publik në qendrat kryesore të Kosovës, e në veçanti në rastet e ndotjes së lartë;
- Te identifikohen pikat kryesore në zonat urbane që shfrytëzojnë thëngjillin, vajrat apo lëndë tjera ndotëse;
- Të rritet inspektimi i përdorimit të lëndëve djegëse në biznese dhe në ekonomitë familjare;
- Të shpejtohen procedurat për miratimin e Planit të Veprimit për Cilësinë e Ajrit dhe plotësim ndryshim i Ligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja;
- Komunat të hartojnë Plane afatshkurtër të veprimit ku duhet të përfshijë masa lidhur me: qarkullimin e mjeteve motorike, ngrohjen në amvisëri, biznese dhe në shërbime tjera, me qëllim të zvogëlimin të shkallës së ndotjes së ajrit;

- Të rritet niveli i vetëdijesimit dhe edukimit mjedisor përmes hartimit të programeve të veçanta;
- Të përkrahen projekte dhe aktivitete që kanë qëllim promovimin e energjisë së ripërtërishme dhe eficientë e energjisë, si dhe të rriten caqet për energjinë solare dhe të erës.
- Të ndahen mjete për kategorinë e subvencioneve të MMPH me qëllim të mbështetjes dhe promovimit të aktiviteteve/projekteve të OJQ-ve dhe komunave në sektorin e mbrojtjes së ajrit nga ndotja.

3. Format e Implementimit

- Inspektimet në terren nga ana e inspektoreve të MMPH, departamenteve tjera qeveritar, drejtorive komunale, dhe marrja e masave për moszbatimin e ligjit;
- Komunikim i rregullt në mes të ministrive të linjës për rritjen e zbatueshmerisë së legjislacionit që ndërlidhen me mbrojtën e ajrit nga ndotja;
- Instalimi i softuerit qendror për mbledhjen e të dhënave të cilësisë ajrit nga stacionet monitoruese dhe paraqitja e tyre në kohë reale përmes ueb aplikacionit dhe Smart Phone (Android dhe iOS);
- Përgatitja e raporteve për vlerësimin e cilësisë së ajrit në baza ditore, javore, mujore dhe paraqitja e tyre në ueb faqe të MMPH/AMMK;
- Hartimi i programit të veçantë për identifikimin e burimeve kryesore të ndotësve të ajrit në zonat urbane;
- Koordinimi i veprimeve me përkrahjen e Policisë së Kosovës në aksione të ndryshme për parandalime dhe ndalime të ndotjes së ajrit;
- Angazhimi i OJQ-ve dhe shoqërisë civile në përkrahje të fushatës;
- Angazhimi i universiteteve në përkrahje të zbatimit të këtij plani;
- Koordinim me menaxhmentin e KEK dhe kompanive gjegjëse për të ndaluar shpërndarjen dhe shitjen e thëngjillit;
- Përgatitja dhe shpërndarja e video-spotëve, fletëpalosjeve, broshurave, publikimeve tjera dhe organizimi i ligjëratave informuese me qytetarë për dëmin dhe pasojat që i shkaktohen ajrit dhe shëndetit nga përdorimi i këtyre lëndëve djegëse.

V. **Rezultatet e pritshme**

- Të gjitha dikasteret përgjegjëse të angazhuara dhe të involvuara në zgjidhjen e këtij problemi;
- Informimi i publikut për cilësinë e ajrit i përmirësuar;
- Paraqitje e te dhënave ne kohe reale përmes ueb aplikacionit dhe Smart Phone i realizuar;
- Lista e ndotësve potencial të ajrit e përgatitur;
- Masave afatshkurtra dhe afatmesme për përmirësimin e cilësisë së ajrit të identifikuara;
- Shitja dhe shpërndarja e lëndëve të ngurtë djegëse, naftës dhe derivateve të saja të kontrolluara;
- Moszbatuesit e ligjit të sanksionuar;
- Niveli i shkarkimeve ndotëse në ajër i zvogëluar;
- Vetëdijesimi i publikut për mbrojtjen e ajrit nga ndotja i përmirësuar.

VI. Shtojcë

Rekomandime të përgjithshme për qytetarët:

- Të kufizohet përdorimi i thëngjillit për ngrohje;
- Të mos përdoren materiale të mbeturinave, vaji i përdorur motorik, mbeturina të llakuara dhe të ngjyrosura të drurit, stiropor, PET, ambalazhe, goma dhe çdo lloj tjetër i materialit sintetik;
- Të përdoret dru i thatë dhe i pastër pa primesa dheu ose mbeturinash;
- Stufat e drurit të përdoren dhe mirëmbahen sipas udhëzimeve të prodhuesit;
- Të pastrohen oxhaqet rregullisht;
- Të reduktohet përdorimi i veturave pa nevojë;
- Të shfrytëzohet sa me shume transporti publik;
- Te shfrytëzohet lëvizja aktive (ecje dhe biçikletë) për ngjarje të përditshme apo vajtje në punë;

Rekomandime për mbrojtjen e shëndetit të njeriut:

- Te shmangët përdorimi i automjeteve dhe të favorizohet përdorimi i transportin publik në mënyrë që të reduktohen emetimet e PM10 dhe PM2.5;
- Gjatë orëve të vona të mbrëmjes ose herët në mëngjes, kur përqendrimet e PM10 mund të arrijnë nivelin maksimal, është e këshillueshme që të shmangni ekspozimin afatgjatë në ambient të hapur;
- Në shtëpitë, në të cilat përdoren lloje të ndryshme të ngrohjeve, të shmangët përdorimi i lëndëve djegëse, të cilat prodhojnë grimca të pluhurit PM10 dhe PM2.5;
- Të anulohen/ shtyhen tubime të mëdha publike, ngjarje sportive dhe ngjarje kulturore në ambient të hapur në kohën kur ka ndotje të theksuar të ajrit.

Rekomandime për institucionet dhe subjektet juridike

- Të shtohet kontrolli i inspektimeve të operatorëve ekonomik, të cilat janë nën kompetencë të MMPH. Njësoj të veprojnë edhe inspektoratet komunale;
- Të rritet kontrolli i inspektimeve të subjekteve që menaxhojnë gomat e përdoruar dhe vajrat e mbetura nga ana e shërbimeve të inspektoreve komunale;
- Të shtohen dhe zbatohen kontrole të jashtëzakonshme inspektimi në vendet e ndërtimit në kompetencë të komunave;
- MASHT te marr masa për ndërrimin e masës së lëndëve djegëse në të gjitha institucionet shkollore;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Ministria e Punëve të Brendshme të implementojnë standardet ekologjike për kontrollin dhe regjistrimin e automjeteve;
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë të marr masa maksimale për kontrollin e cilësisë së karburanteve;

- Të pastrohen rrugët dhe sipërfaqet për këmbësorë në kompetencë të komunave, posaçërisht në qytetin e Prishtinës;
- Dërgimi i mallrave me automjete të bëhet para orës 7:30 ose pas orës 18:00;
- Trajnimi i kandidatëve në auto shkollave të realizohet nga ora 9:30 deri në 14:30 dhe pas orës 18:00;
- Të gjitha subjektet juridike (institucionet administrative dhe publike) të cilat për ngrohje përdorin pajisje për djegie – kazantore, të njëjtat t'i kontrollojnë në mënyrë që të sigurojnë regjimin optimal të djegies, siç përcaktohet nga udhëzimet e prodhuesit të pajisjeve;

Rekomandime për prodhuesit, importuesit dhe shitësit e produkteve për sistemet e ngrohjes dhe lëndëve djegëse

- Shitësit e qymyrit të ndërprejnë shitjen dhe furnizimin e qytetareve me këtë lëndë djegëse;
- Shitësit e pajisjeve për ngrohje të mënjanojnë shitjen e pajisjeve që mundë të djegin qymyrin, vajrat, masat plastike etj;
- Shitësit e pajisjeve eficientë dhe miqësorë me mjedisin të paraqesin kërkesa për përkrahje, për të lehtësuar importin, zhdoganimin, montimin dhe subvencionimin;
- Qeveria, Komunitat dhe operatorët të favorizojnë instalimin dhe përdorimin e pajisjeve ngrohëse që janë miqësore me mjedisin.